

Sanja Peresha – Macuka
Igor Jovaniviq

Futbolli dhe politika





Pyetja kyçe

Futbolli nuk ka të bëjë asgjë me politikën.

Deri në cilën masë pajtoheni me këtë konstatim?



Tema

Ky modul është vështrim për jetën sportive në periudhën 1918-1930, më saktësisht për një rast të njohur dhe problemet të cilat u shfaqën lidhur me ekipin nacional jugosllav në kampionatin e parë botëror të futbollit, në Uruguai.

Kjo temë është zgjedhur sepse supozonim se do të jetë interesante për shumicën e nxënësve dhe mësimdhënësve. Tema është kontroverse sepse ndikimi i politikës dhe sportit mund të na ndihmojë t'i ofrojmë problemet siç janë: kombi në Mbretërinë Jugosllave, diktatura, centralizimi, konfliktet politike, unitarizmi... Qëllimi ynë është t'u paraqitet nxënësve çështje serbo-kroate në një incident/rast të vogël interesant.



Qëllimet

Analiza kritike e burimeve për pjesëmarrjen e ekipit jugosllav në Kampionatin e Parë Botëror të Futbollit dhe problemet e marrëdhënieve mes kombeve në Mbretërinë Jugosllave.

Varësisht nga dituritë për historinë lokale dhe botërore të sportit. Prezantimi i pjesës zbavitëse të historisë dhe zgjimi i interesit për historinë si shkencë.



Rezultatet e të mësuarit

1. Nxënësit do të zhvillojnë mendim kritik nëpërmjet mësimin të shkaqeve dhe pasojave.
2. Nxënësit do të gjejnë lidhje mes konfliktit politik dhe sportit.
3. Do ta krahasojnë këtë rast të njohur nga historia me problemet dhe dhunën që ndodh sot mes dashamirëve të sportit.
4. Përforcimi i interesit dhe entuziazmit për lëndën.

Udhëzime për mësimdhënësin

Mësimdhënësi ia prezanton temën klasës. Punësoria ka dy faza – faza e parë është puna individuale në çifte, ndërsa faza e dytë është puna grupore dhe prezantimi i rezultateve.

HAPI 1/motivimi: Hyrje dhe motivim – mësimdhënësi e lexon hyrjen, pastaj e tregon fotografinë e topit të vjetër nga lëkura nga shek. XIX. Nxënësit do të përgjigjen në pyetjen e parashtruar dhe përfundohet me atë se çka dinë për historinë e futbollit.

- Përpuni të krahasoni luajtjen e futbollit tani dhe para 100 viteve.
- Si ishin kushtet?
- A di diçka për historinë e futbollit?

HAPI 2/ "Futbolli në Mbretërinë Jugosllave": Punë në grupe – Analiza e fotografisë dhe plotësimi i tabelës – Nxënësit i analizojnë burimet për paralajmërimin e gazetës për lojërë të reja interesante – futbollit, burim për kampionatin e parë botëror të futbollit dhe themelimin e Lidhjes së Futbollit në Zagreb.

Pyetje të propozuara për diskutim:

- A e konsiderojmë futbollin si sport të vjetër tradicional? Pse?
- Emëro disa klube të famshme të futbollit nga fillimi i shek. XX.
- Kur u themelua Asociacioni Jugosllav i Futbollit dhe ku ishte selia e tij? Pse?

HAPI 3/ "Centralizimi dhe futbollit": Punë në grupe – leximi dhe analiza e burimeve, krijimi i shiritit të vogël të kohës. Detyra është analiza e burimeve dhe plotësimi i shiritit të kohës duke i bashkuar të gjitha burimet me data. Në fund do ta rindërtojë rrëfimin duke e shikuar vështrimin kroat, serb, sloven dhe ndërkombëtar.

Pyetje dhe detyra:

- Vendosi burimet në radhë kronologjike dhe bën shirit kohe.
- Analizoj të gjitha këndvështrimet për zhvendosjen e Lidhjes së Futbollit nga Zagrebi në Beograd. Çka mund të përfundosh?
- Pse është e rëndësishme që selitë e lidhjeve të futbollit të jenë në kryeqytetin e shtetit? Sqaroje mendimin tënd.



45
minuta

HAPI 4/ “Kampionati botëror pa lojtarë kroatë”: Punë grupore – leximi dhe analiza e burimeve. Pas hyrjes së shkurtër, nxënësit do të punojnë në grupe. Detyra është të analizohen burimet për Kampionatin e Parë Botëror të Futbollit, duke iu përgjigjur tre pyetjeve nga detyra:

Pyetjet dhe detyrat:

- Pse lojtarët kroatë refuzonin të luanin për ekipin kombëtar në Kampionatin Botëror?
- Gjeje lidhjen mes politikës dhe sportit, biznesit dhe sportit, dikur dhe sot. Sqaro!
- A njih ndonjë lojtar të kohës së sotme i cili ka refuzuar të luajë për reprezentacionin kombëtar dhe pse?
- Cilat janë arsyet e mundshme për refuzimin e ftesës së reprezentacionit sot, e cilat dikur?

HAPI 5/

a) Kthimi dhe reagimet-

Punë në grupe – leximi dhe analiza e burimeve.

Nxënësit do t'i analizojnë burimet dhe do t'u përgjigjen pyetjeve të dhëna. Në fund do të nxjerrim përfundim të përbashkët dhe do ta plotësojmë tabelën: Shkaqet / incidenti / pasojat

Pyetje:

- Krahasoje pritjen e ekipit kombëtar në Lubjanë, Zagreb dhe Beograd. Çka mund të përfundosh?
- Pse në Zagreb pati pritje të ftohtë?
- Ndërlidhe pritjen e këtyre me gjendjen në vend gjatë atyre ditëve.

b) Çështjet financiare

Pyetje dhe detyra:

1. Përmend disa probleme në lidhje me paratë pas mbarimit të Kampionatit Botëror.

Në fund ne do të përfundojmë bashkërisht dhe do ta mbushim tabelën: shkaqet/incidentet/pasojat.

Tabela nr. 1



shkaqet	incidentet	pasojat

Punëtorinë mund ta mbyllim me pyetjen kyçe:

**‘Futbolli nuk ka të bëjë asgjë me politikën’ .
Deri në cilën masë pajtoheni me këtë konstatim?**

Hyrje

- Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve (më vonë Mbretëria Jugosllave) është themeluar në vitin 1918 me qendër në Beograd. Pas vitit 1918 u vendosën lidhje të reja, mbinacionale sportive. Disa prej tyre u themeluan në Zagreb, siç ishin Komiteti Olimpik Jugosllav dhe Lidhja e Futbollit e Jugosllavisë.
- Përpjekjet që të krijohet shteti unitar centralist me qendër në Beograd krijojnë tensione, posaçërisht mes kroatëve dhe serbëve. Pasi që selia kryesore e Lidhjes së Futbollit të Jugosllavisë u bart në Beograd, pjesëtarët kroatë të reprezentacionit refuzuan të luajnë për ekipin nacional tre vitet e ardhshme.
- Tensionet mes kroatëve dhe serbëve në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve (nga vitit 1929 Mbretëria Jugosllave) do të manifestohen gjithashtu edhe në futboll.

Burimi 1


Topi i shek. XIX



Zupanja – koljevka hrvatskog nogometa, Zupanja, 2005.

Burimi 2

Topi i shek. XIX, monument i topit të parë



Zupanja – koljevka hrvatskog nogometa, Zupanja, 2005.

Pyetje:

1. Mundohu të krahasosh luajtjen e futbollit tani dhe njëqind vjet më parë.
2. Cilat ishin kushtet?
3. A din diçka për historinë e futbollit?

Burimi 1

Thirrje për të mësuar luajtjen e futbollit (1893).

“Meqë në kohën e fundit gjithkund në Evropë, por edhe jashtë Evropës, disa lojëra ia kanë marrë hovin shoqatave gjimnastike dhe lojërave gjimnastike, posaçërisht të ashtuquajturat lojëra angleze si tenisi në fushë, futboli, kriketi (...), “Sokoli Kroat” vendosi t’i njoftojë anëtarët e vetë me disa prej atyre lojërave (...) Lojërat do të fillojnë javën e ardhshme, ndërsa së pari do të mësohet tenisi në fushë dhe futboli.

Sto godina nogometa u Hrvatskoj 1880. – 1980., NIŠRO Prosvjeta, Bjelovar 1984., glavni urednik Franjo Frntić

Burimi 2

Themelimi i Lidhjes Jugosllave të Futbollit në Zagreb

Në vitet 1912/1913 u luajt Kampionati i Parë i Futbollit i Kroacisë dhe Sllavonisë me gjashtë klube. Kampion ishte HASHK. Kampionati i dytë filloi në vitin 1913, por nuk përfundoi për shkak të Luftës së Parë Botërore. Themelimi i Lidhjes Jugosllave të Futbollit ndodhi në Kuvendin në Zagreb më 15 prill 1919. Në atë Kuvend, krahas delegatëve nga Kroacia ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e disa regjioneve të tjera dhe pas diskutimit për themelimin e organizatës së futbollit mbisundoi mendimi që është më e udhës dhe më e dobishme të themelohet organizata e futbollit e shtetit të ri të Serbëve, Kroatëve dhe Sllavenëve. Kështu, atë ditë, në vend të ripërtëritjes së punës së seksionit të futbollit dhe themelimit të Lidhjes Kroate të Futbollit, është themeluar Lidhja Jugosllave e Futbollit (LJF) me seli në Zagreb.

Sto godina nogometa u Hrvatskoj 1880. – 1980., NIŠRO Prosvjeta, Bjelovar 1984., glavni iurednik Franjo Frntić

Burimi 4

Tabela e kampionëve dhe nënkampionëve të Jugosllavisë nga viti 1923 deri në vitin 1930.

*www.rsssf.com (19.07.2013)
World's organization for football history and statistics*

	Klubi	Kampion	Nënkampion
1	BSK Beograd	5	5
2	Gradjanski Zagreb	5	2
3	Hajduk Split	2	5
4	Jugoslavija Beograd	2	3
5	Concordija Zagreb	2	1
6	HASHK Zagreb	1	0
7	Sllavija Sarajevë	0	1
8	SASHK Sarajevë	0	1

Burimi 3

Ekipi Kombëtar Jugosllav

Ekipi Kombëtar Jugosllav e luajti lojën e tij të parë ndërkombëtare në Turnirin Olimpik në Antverpen në vitin 1920. Dy humbje të rënda dhe vendi i fundit në turnir, pas së cilave vijonin pjesëmarrje në olimpiadat në Paris dhe Amsterdam, nuk i shkurajuan pionierët e futbollit. Ekipi nacional vazhdoi të luajë lojëra miqësore dhe turnirë lokalë (Kupa e Ballkanit, Kupa e Vendeve Fqinje), ndërsa në vitin 1930 morri pjesë në Kampionatin e Parë Botëror në Uruguai. Lidhja e Futbollit është themeluar në vitin 1919, edhe pse klubi i parë u themelua në Suboticë në vitin 1901 – KF Baçka. Klubi iu prezantua publikut në ndeshjen miqësore kundër klubit hungarez TK Mohacs. Në vitin 1903 Beogradi dhe Zagrebi i fituan foshnjat e tyre të para të futbollit: Sokolin dhe HASHK (Krvatski akademski shportski klub – Klubi akademik sportiv kroat). Futbolli u popullarizua shumë, andaj u themeluan klubet në Lubjanë (Iliria), Kragujevac (Shumadi), Novi Sad (NAK), Sarajevë (Gragjanski), Varazhdin (VGSHK), Split (Hajduk), Beograd (BSK, Jugosllavi, BASK...), Zagreb (Gragjanski, Concordia, Akademia, PNISHK)... Kampionati i parë nacional u mbajt në vitin 1923 dhe fituesit ishin Gragjanski dhe Zagrebi. Deri në Luftën e Dytë Botërore, Gragjanski dhe BSK Beograd fituan pesë tituj të kampionit dhe përbënin boshtin e ekipit nacional. Në vitin 1929 selia e Lidhjes së Futbollit të Jugosllavisë u shpërngul nga Zagrebi në Beograd. Antagonizmi kryetarit serb dhe kroat shpërtheu dy herë: së pari në vitin 1930, kur klubet kroate ua ndaluan lojtarëve të vetë të luajnë për ekipet nacionale, ndërsa pastaj edhe në vitin 1933, kur kampionati nuk u mbajt sepse klubet nuk kishin mundësi të merren vesh rreth sistemit të garave.

*www.rsssf.com (19.07.2013)
World's organization for football history and statistics*

Pyetje:

1. A e konsiderojmë futbollin sport të vjetër dhe tradicional? Pse?
2. Emëro disa klube të famshme të futbollit nga fillimi i shek. XX.
3. Kur u themelua dhe ku ishte selia e Lidhjes Jugosllave të Futbollit?

Hyrje

Elita politike serbe insistonte në shtetin e centralizuar, duke e kundërshtuar idenë e federalizmit të cilën e kërkonte shumica e liderëve politikë kroatë. Qeveria e udhëhequr nga serbët në Beograd përpqej të formojë shtet të centralizuar duke i zhvendosur institucionet shtetërore në kryeqytet. Zhvendosja e selisë së Lidhjes së Futbollit ishte pjesë e këtij procesi. Lidhja Jugosllave e Futbollit është themeluar në vitin 1919 në Zagreb ndërsa në vitin 1930 është zhvendosur në Beograd.

Burimi 1**Centralizimi**

Qeveria e 6 janarit punonte për krijimin e organizatave, shoqatave dhe asociacioneve të mbështetura në ideologjinë e jugosllavizmit neutral. Këto veprime posaçërisht u forcuan në viset e quajtura "preçanski krajevi". Në dhjetor të vitit 1929 u formua organizata e parë shtetërore e kulturës fizike (Sokoli i Mbretërisë Jugosllave). Mbështetja e plotë në fushën e kulturës trupore u bë në vitin 1931 me formimin e Ministrisë së Edukimit Fizik të Popullit. U krijuan Lidhja Jugosllave e Gjuajtjes, Lidhja e Zjarrfikësve të Jugosllavisë, Lidhja Vëzhguesve Jugosllavë, Lidhja e Sporteve dhe Lidhjeve Sportive që përfshinte një sërë sportesh. Sporti në Mbretërinë Jugosllave, në mënyrë organizative i lidhur me Lidhjen shtetërore të lidhjeve sportive, fitoi rol të rëndësishëm në zbatimin e arsimit ushtarak të rinisë.

**Kjo shprehje përdorej për t'iu referuar zonave të banuara me serbë, por jashtë Serbisë, kryesisht në perëndim të lumit Drina.*

Branko Petranović: *ISTORIJA JUGOSLAVIJE, knjiga I - KRALJEVINA JUGOSLAVIJA*, www.znaci.net/00001/93_6pds. (19.07.2013)

Burimi 3**Kuvendi i Lidhjes Jugosllave të Futbollit**

Zagreb, 16 mars
"Jutarnji list" shkruan: "Sot këtu u mbajt Kuvendi Kryesor i Lidhjes Jugosllave të Futbollit. Sipas planit të punës, ky Kuvend duhej të ishte vazhdim i Kuvendit të 24 nëntorit të vitit të kaluar dhe kishin mundësi të votojnë vetëm ata që ishin verifikuar atëherë. Menjëherë u kalua në diskutim për ndryshimin e nenin 1 të rregullave të Lidhjes për selinë e Lidhjes. Me 213 vota u krijua konkluzioni që ky paragraf të ndryshohet dhe si seli e Lidhjes së caktohet Beogradi. Atje u shpërngul edhe Kuvendi i arbitrave të futbollit".

Jutarnji list, 16.03. 1930.

Burimi 2**Qëndrimi kroat**

Në kuvendin e rregullt të Lidhjes Jugosllave të Futbollit të mbajtur më 16 mars të vitit 1930 në Zagreb, në periudhën kur në fuqi ishte diktatura e 6 janarit, me shumicë të votave të delegatëve u soll vendimi që Selia e Lidhjes të shpërngulet nga Zagrebi në Beograd. Janë të njohura faktet që, sipas rregullave të atëherëshme, klubi anëtar i Lidhjes nuk ishte i obliguar që në Kuvend të dërgojë delegatin e tij. Klubet e vogla të regjistruara u jepnin autorizim përfaqësuesve të klubeve më të mëdha për të cilat besonin se udhëheqin politikë të drejtë futbollit. Secili autorizim në Kuvend kishte kuptim të edhe një vote, dhe në atë kohë delegatë të caktuar të Kuvendit dispononin me disa vota në bazë të autorizimeve të klubeve të futbollit. Kjo ishte vendimtare për sjelljen e vendimit, sepse një delegat kishte mundësi të ketë dhjetëra vota. Kështu, një delegat nga Zagrebi për Kuvendin, kur flitej për shpërnguljen, dispononte me gjithsejtë 26 autorizime nga territori i tij. Në mënyrë të pasqyruar gjatë natës mes së shtunës dhe të dielës këto autorizime u zhdukën, kështu që në Kuvend nuk kishte mundësi që të dëshmohej. Pikërisht zhdukja e këtyre 26 autorizimeve ishte vendimtare për vendimin e shpërnguljes së Lidhjes Jugosllave të Futbollit nga Zagrebi në Beograd.

Sto godina nogometa u Hrvatskoj 1880. – 1980., NIŠRO Prosvjeta, Bjelovar 1984., glavni urednik Franjo Frntić

Burimi 4**Para Kuvendit të Lidhjes Jugosllave të Futbollit**

Nesër me fillim në orën 8 në Kuvendin e Qytetit do të mbahet Kuvendi i Lidhjes Jugosllave të Futbollit në të cilën do të diskutohet për çështje shumë të rëndësishme. Për kuvendin ekziston një interes i madh në të gjitha qarqet e futbollit në tërë vendin sepse në rend dite janë propozime shumë të rëndësishme. Në Zagreb kanë arritur delegatët nga Sarajeva, Osijeku, Beogradi, Shkupi, Spliti, Lubjana dhe Subotica. Shumë klube do t'i dërgojnë përfaqësuesit e tyre. Tema kryesore e diskutimit do të jetë ndryshimi i rregullave. Është e mundur të vijë deri te diskutimi për shkak të mjaft klubeve të paraqitura në Nënldhjen e futbollit të Zagrebit. Më pas do të flitet për propozimin për ndryshim për luajtjen e lojërave shtetërore të kampionatit të Nënldhjes së Lubjanës, pastaj për ndërveprimin në kampionatin botëror, për ndryshimin e mënyrës së delegimit të arbitrave në ndeshje, të cilën e propozon Nënldhja nga Subotica etj. Në kuvend do të mund të marrin pjesë vetëm delegatët e klubeve dhe personat që kanë leje të posaçme.

Slovenec, br.63. 16.03. 1930.

Burimi 5

Selia e Lidhjes Jugosllave të Futbollit zhvendoset në Beograd

Shumica e delegatëve nga Nënlihdja e Zagrebit, Splitit dhe Osijekit e lëshuan kuvendin para votimit! Udhëheqja e re u zgjodh me aklamacion”

*aklamacion – kryerja e zgjedhjes me pohim të përgjithshëm, pa votim individual.

Politika', 17 Mars 1930

Burimi 6

Pas vendimit të rëndësishëm për bartje së Lidhjes Jugosllave të Futbollit në Beograd

“Kuvendi i së dielës i Lidhjes Jugosllave të Futbollit e hoqi nga rendi i ditës një problem të madh të jetës sportive jugosllave. Për çështjen e bartjes së selisë së lidhjes jugosllave sportistët u ndanë në dy grupe, që ende nuk ishte ndonjë e keqe e konsiderueshme. Por beteja për mbetjen e Lidhjes në Zagreb u bë aq e shtrembëruar, saqë aty njeriu nuk mundte të shohë fundin e betejës së pakuptimtë dhe josportive”.

Politika', gazetë ditore e afërt me Qeverinë, Beograd, 19 mars 1930.

Burimi 7

Udhëheqja e re e Lidhjes Jugosllave të Futbollit ia filloi punës**Zagreb, 18 mars**

Dje në mëngjes përfaqësuesit e gjertanishëm të Lidhjes Jugosllave të Futbollit e pranuan njoftimin policor se menjëherë duhet t'i bartin detyrat zyrtare këshillit të porsazgjedhur. Sot (pasdite) në orën 15:00 kjo edhe u bë.

Slovenec, Novine Slovenske pučke stranke, br 65, 19.3.1930.

Burimi 8

Deklarata e Hugo Meisl*

“Sa i përket pranimit të ndryshimeve të reja për udhëheqësin e futbollit jugosllav në F.I.F.A., mund t'ju them se do ta pranojë udhëheqjen e cila është legalizuar te shteti”.

“Nëse me këtë pajtohen klubet sportive jugosllave, unë do të pajtohem që të ndërmjetësoj mosmarrëveshjet mes Beogradit dhe Zagrebit”.

*Hugo Meisl = Përzgjedhësi i Austrisë dhe anëtar i udhëheqjes së F.I.F.A.

Politika, 20 Mars 1930

Burimi 9

Mbledhja e parë e Lidhjes Jugosllave të Futbollit në Beograd

“Mbrëmë në Beograd u mbajt mbledhja e parë e Lidhjes Jugosllave të Futbollit. Pas diskutimit të gjerë u refuzua vërejtja e Nënlihdjes së Zagrebit, që Lidhja është zhvendosur në Beograd me forcë, e jo me mjete legale”.

Hrvatski list, 23. 03. 1930.

Pyetje:

1. Lexoji burimet sipas radhës kronologjike dhe bëj shirit kohe.
2. Analizoj të gjitha pikat e këndvështrimeve për zhvendosjen e Lidhjes së Futbollit nga Zagrebi në Beograd. Çka mund të përfundoni?
3. Pse është e rëndësishme që selia e lidhjes së futbollit të jetë në kryeqytetin e shtetit? Sqaroje përgjigjen tënde.

Hyrje

Kishte mjaft probleme me ekipin nacional jugosllav gjatë përgatitjeve për Kampionatin Botëror në Uruguai në vitin 1930. Lidhja Jugosllave e Futbollit u themelua me seli në Zagreb në vitin 1919. Zhvendosja e selisë nga Zagrebi në Beograd ishte vendim politik me pasoja të këqija. Duket se futbollit çdoherë ishte më tepër se lojë për shumicën e qytetarëve. Më parë kryetarët e Lidhjes Jugosllave të Futbollit ishin kryesisht kroatë – dr. Hinko Wirth, dr. Ante Jakovac, dr. Miroslav Petanjek, dr. Veljko Ugriniq, dr. Kazimir Kremetiq, dr. Ivo Lipovshçak, Dragan Vuçkoviç, Vatroslav Krçeliq, Ante Pandakoviç dhe Janko Shafarik. Përzgjedhësit e futbollit gjithashtu shumica ishin kroatë – Veljko Ugriniq, Dushan Zinaja dhe Ante Pandakoviç. Qytetarët kroatë dhe publiku ishin të mënjanuar, të hidhëruar dhe të revoltuar. Nëntë lojtarë kroatë nga lista e lojtarëve për Uruguai refuzuan të luajnë për ekipin kombëtar jugosllav në kampionatin botëror. Lojtarët nga Sllovenia dhe Subotica iu bashkëngjitën dhe i tërhoqën lojtarët e tyre. Pas lojës në Athinë më 1930, reprezentacionin jugosllav e lëshoi edhe përzgjedhësi Ante Pandakoviç (gjithashtu kroat). Përzgjedhësi i ri ishte futbollist i dikurshëm dhe arbitër sportiv i parë ndërkombëtar serb, Boshko Simonoviç.

Burimi 1

Nata e parë në anijen “Florida”



Politika', 26. 06. 1930, br. 7950 – godina XXVII

Burimi 2

Jugosllavia arriti rezultate të rëndësishme, duke e ndarë vendin e tretë me ekipin e SHBA-s, ndërsa në takimin e parë në hapje fituan favoritet absolutë – ekipi i Brazilit – 2:1.



Politika, Beograd, 15. 7. 1930.

Burimi 3

Pa kroatët

Në gazetat që bliheshin në Zagreb nuk kishte asgjë për pjesëmarrjen e Jugosllavisë në Montevideo. Lajmi i vetëm në lidhjen me garën në vijimi ishte deklarata e një punëtori të futbollit nga Zagrebi i cili tha dhe mbeti pa pasoja:

“Ne mbajmë llogari për shëndetin e lojtarëve tanë dhe nuk lejojmë që të udhëtojnë në Montevideo, në aventurë e cila mund t'i vendosë në pikëpyetje jetët e tyre. Ata atje do të kenë uri dhe ndihemi keq për të gjithë ata që kanë shkuar në këtë rrugë përtej detit”, shkruante nëpër gazeta.

Në kupën botërore pa lojtarë kroatë – fejtën në gazetën “Blic”, edicioni online 21 prill 2010; marrë nga libri: Vladimir Stanković “Montevideo bog te video”, Beograd

Burimi 4

Sot Jugosllavia luan kundër Bolivisë

-Sot Jugosllavia luan kundër Bolivisë
-Jugosllavia është favorit – “Ekipi më i mirë, të parët e Evropës”, shkruan shtypi i Uruguait për lojtarët tanë.



Politika', 17 Korrik 1930

Pyetje:

1. Përse lojtarët kroatë refuzuan të luajnë në ekipin kombëtar në Kampionatin Botëror?
2. Gjeje lidhjen mes politikës dhe sportit, biznesit dhe sportit, dikur dhe sot. Sqaro!
3. A njeh ndonjë lojtar të sotëm i cili ka refuzuar të luajë në reprezentacionin nacional dhe pse?
4. Cilat janë arsyet e mundshme për refuzimin e ftesës së reprezentacionit sot, e cilat dikur?

Burimi 1

Kthimi i ekipit kombëtar

Pritja ishte e ngrohtë, si gjithandej gjatë rrugës. Së pari në Lubjanë, pastaj në Zagreb, Sisak, Nova Gradishkë. Në Shid adhuruesit e tekstualisht e okupuan vagonin në të cilin ishin lojtarët, ndërsa kulminacioni ishte në Beograd, ku në stacionin hekurudhor prisnin rreth 5.000 njerëz të ngazëllyer. Futbollistët tekstualisht u nxorën nga treni nëpërmjet dritareve të vagonëve dhe në krahë adhuruesit i nxorën në sheshin Terazie...

Vladimir Stanković, Montevideo! Bog te video, Beograd 2010.

Burimi 2

Pritja në Lubjanë (sot kryeqytet i Sllovenisë)

“Në mëngjes në orën 9:05 me trenin e shpejtë në Lubjanë arriti reprezentacioni ynë sportiv, i cili me sukses të madh luftoi në fushat e futbollit të Amerikës Jugore dhe arriti rezultate të lakmueshme duke e prezantuar në botën e jashtme sportin tonë. Me këtë rast në stacionin e Lubjanës u mbledhën mjaft njerëz dashamirë të sportit, i cili në mënyrë të ngrohtë e priti reprezentacionin tonë të futbollit dhe e përshëndeti”.

„Politika“, Shtator 1930., br. 8018 – godina XXVII

Burimi 3

Pritja në Zagreb

Mirëseardhja në Zagreb, 1 gusht 1930.
“Sot në orën 12:30 me trenin e shpejtë nga Parisi arriti në Zagreb ekipi ynë i futbollit nga Montevideo. Në stacionin e Zagrebit mungoi çdo pritje sportive. Të pranishëm ishin vetëm korrespondentët sportivë të gazetave të Beogradit”.

„Politika“, Beograd, 2. 09. 1930., br. 8018 – godina XXVII

Burimi 4

Mirëseardhja

“Mijëra adhurues në pritjen e reprezentuesve tanë në stacionin e madh hekurudhor në Beograd”.



Politika“, Shtator 1930., br. 8018 – godina XXVII

Burimi 5

Ekipi jugosllav (pas kthimit) në Beograd, 3 shtator 1930

Vladimir Stanković, Montevideo Bog te video, Beograd

Pyetje:

1. Krahasoje pritjen e ekipit kombëtar në Lubjanë, Zagreb dhe Beograd. Çka mund të përfundosh?
2. Pse në Zagreb i priste pritja e ftohtë?
3. Ndërlidhe pritjen e këtyre me situatën në vend gjatë atyre ditëve.

Burimi 6

Aferë për shkak të parave dhe dorëheqjes së kryetarit të Lidhjes Jugosllave të Futbollit

Afera për shkak të parave nga Amerika Jugore gjithnjë e më tepër po ashpërsohet. KSB vendosi të dorëzojë akt padi kundër Lidhjes Jugosllave të Futbollit. Beograd, 23 gusht

“Çështja e ndarjes së 450.000 dinarëve të cilat reprezentacioni i sollti nga Uruguai fiton formë gjithnjë e më të ashpër dhe duket se çështja do të mbarojë para gjyqit. Përderisa disa kërkonin që paratë të dorëzohen pranë Lidhjes Jugosllave të Futbollit në dobi të sportit të përgjithshëm jugosllav, të tjerët kërkonin që paratë t’i jepen KSB-së (Klubit Sportiv të Beogradit), sepse ai është merituar që reprezentacioni shtetëror shkoi jashtë vendit. Raportuam se kryetari i Lidhjes Jugosllave të Futbollit, Shafarik, dhe përzgjedhësi i kombëtares, Simonoviq, dhanë dorëheqje sepse kërkuan që gjysma e parave t’i jepen KSB-së.

Hrvatski list, 23 septembar 1930

Burimi 7

Ndarja e shpërblimit

“Në Jugosllavi nëpërmjet gazetave së shpejti do të fillojë fushata për drejtimin e mohimit të cilësisë së “Reprezentacionit të Serbisë” dhe mënyrës së prezantimi të futbollit jugosllav. Humbjet e reprezentacionit të Beogradit dhe KSB-së në lojërat miqësore do të quhen “turp” i reputacionit jugosllav duke harruar që këtë renome e ngriti pikërisht kjo përzgjedhje e futbollistëve. Megjithatë, nuk do të quhet “turp” shuma e madhe e parave të fituara (mbi 450.000) dinarë, por do të kërkohej që e gjithë shuma t’i takojë Lidhjes Jugosllave të Futbollit, sikur lojërat miqësore ti ketë luajtur reprezentacioni shtetëror, me urdhër nga Jugosllavia. Edhe pse KSB-ja në delegacionin e futbollistëve në Uruguai i kishte më shumë se dy të tratat e përfaqësuesve, kërkonte vetëm një të tretën e mjeteve për shkak të mbulesës së shpenzimeve gjatë realizimit të këtij fitimi. Krahas kësaj, KSB-ja për shkak të renomesë së futbollit jugosllav e sakrifikoi renomenë e vet, duke luajtur në kampionatin shtetëror me përbërjen rezervë.

Mosmarrëveshja disamujore në majën e futbollit jugosllav do të mbarojë me vendimin e Kuvendit të Lidhjes Jugosllave të Futbollit në dobi të KSB-së, më 14 dhjetor 1930.

Në ndërkohë për shkak të ankesave nga regjioni futbollist i Zagrebit se “do të ishte çdo gjë ndryshe nëse selia e Lidhjes do të mbetej në Zagreb” kryetari i Lidhjes Jugosllave të Futbollit Janko Shafariq dha dorëheqje dhe përgjithmonë u tërhoq nga sporti i futbollit”.

Petar M. Prokić, Montevideo 1930.- Prvi svetski kup u fudbalu, Beograd 1998., str. 94.-95.

Burimi 8

Mbledhje e trazuar i klubit të futbollit

Mbrëmë Këshilli i KSB-së mbajti mbledhje. Kryetari i klubit, Dr. Zhivkoviq, raportoi për çështjen e shpërndarjes së parave dhe theksoi se disa anëtarë të Lidhjes Jugosllave të Futbollit premtuan të ndajnë gjysmën e fitimit nga Amerika Jugore për Klubin Sportiv të Beogradit. Sidoqoftë, këta anëtarë nuk i plotësuan premtimet e tyre, dhe meqë Zhivkoviq ndjeu se në njëfarë mënyre e dëmtoi klubin, dha dorëheqje nga pozita e kryetarit. Dorëheqja nuk u pranua, dhe klubi do të merret me këtë çështje në kohë të duhur. Gjithashtu u vendos që të ngrihet një akt padi në gjyqin e rregullt kundër Lidhjes Jugosllave të Futbollit, duke theksuar se Lidhja Jugosllave e Futbollit si forum përpiqet t’i mbajë paratë në mënyrë të paligjshme, edhe pse i takojnë klubit”.

Hrvatski list, 20.9.1930

Pyetje:

- Përmend disa probleme në lidhje me paratë pas mbarimit të kampionatit botëror.
- Në fund bashkërisht nxjerrim përfundim dhe e plotësojmë tabelën: shkaqet / incidenti / pasojat.

Shkaqet	Incidenti	Pasojat